

Marrëveshje në mes qeverisë së Republikës së Austrisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim kulturor

Qeveria e Republikës së Austrisë dhe qeveria e Republikës së Kosovës, tutje të referuara si "palët kontraktuese":

në përpjekje për të zgjeruar bashkëpunimin e mëtejshëm mes dy shteteve, të vetëdijshme për nevojën e promovimit të bashkëpunimit kulturor,

janë pajtuar si më poshtë:

Neni 1

(1) Palët kontraktuese mirëpresin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në fushat e mësimdhënies dhe hulumtimit mes universiteteve të tyre dhe instituteve shkencore.

(2) Palët kontraktuese inkurajojnë studimet në territorin e palës tjetër kontraktuese. Tarifat studimore aplikohen sipas ligjeve të palëve përkatëse kontraktuese.

(3) Palët kontraktuese ftojnë studentët, të diplomuarit, profesorët universitarë si dhe hulumtuesit e tyre për të aplikuar në kuadër të programeve përkatëse të bursave të palës tjetër kontraktuese.

(4) Të dyja palët kontraktuese inkurajojnë një bashkëpunim të zgjeruar në kuadër të programeve rajonale dhe evropiane në fushën e arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor.

(5) Palët kontraktuese mirëpresin aktivitetet për të mbështetur zhvillimin pozitiv të sistemit të inovacionit të Kosovës, në veçanti zhvillimin e kapaciteteve dhe zhvillimin institucional - "Institution Building" në fushat si: akreditimi, njohja e titujve akademikë dhe diplomave, hulumtimet dhe promovimi i shkencëtarëve të rinj, ashtu si në vitin 2006, në kuadër të "Umbrella Memorandum Of Understanding Between the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo Acting on behalf of and for the benefit of the Provisional Institutions of Self-Government in Kosovo (Ministry of Education, Science and Technology) and the Federal Minister of Education, Science and Culture and the Federal Minister for Foreign Affairs of the Republic of Austria", implementimi i së cilës kishte filluar suksesshëm.

Neni 2

(1) Palët kontraktuese bazuar në mundësitë financiare do të mbështesin bashkëpunimin në fushën e arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional si dhe arsimit të të rriturve në nivel bilateral dhe rajonal, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të masave si më poshtë:

- a) Shkëmbimit të ekspertëve si dhe informacioneve – materialeve dhe literaturës profesionale, veçanërisht mbi zhvillimet e reja në arsim;
- b) Aktiviteteve dhe iniciativave në fushën e arsimit të pedagogëve;
- c) Bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të firmave ushtrimore;
- d) Aktiviteteve të "KulturKontakt Austria" në fushën e arsimit;
- e) Shkëmbimit të përvojave në zbatimin e iniciativave të BE-së në fushën e arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional, poashtu në bashkëpunim me "European Training Foundation".

(2) Zbatimi i këtyre masave do të bëhet në marrëveshje mes palëve kontraktuese. Hollësitë do të përcaktohen në programet e Komisionit të Përbashkët (neni 8).

Neni 3

Palët kontraktuese inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e rolit të gruas dhe barazisë gjinore, veçanërisht përmes shkëmbimit të ekspertëve si dhe përmes shkëmbimit të dokumenteve dhe materialeve informuese.

Neni 4

(1) Palët kontraktuese do të përpiqen të zgjerojnë njohuritë kulturore të palës tjetër kontraktuese, të thellojnë zhvillimin e bashkëpunimit kulturor në të gjitha fushat dhe nivelet kulturore dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në identitetin kulturor evropian.

(2) Në këtë kuptim, palët kontraktuese bazuar në mundësitë e tyre do fokusojnë, , bashkëpunimin e tyre:

- a) në shkëmbimin e informacioneve mbi konferencat dhe seminarët ndërkombëtarë që kanë të bëjnë me çështjet kulturore, të cilat do të zhvillohen në territorin e palës tjetër kontraktuese;
- b) në ftesa të ndërsjella për paraqitje të artistëve dhe ansambleve, organizimin e koncerteve, festivaleve, lojrave festive, shfaqje në fushën e vallëzimit, teatrit, teatrit muzikor dhe prezantimeve të tjera artistike në nivel kombëtar, rajonal e lokal.
- c) në organizimin e ekspozitave në kuadër të bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë të institucioneve të fushës kulturore si dhe nxitjen e kontakteve në fushën e artit bashkëkohor pamorë, arkitekturës, dizajnit, modës, fotografisë, artit mediatik, industrisë së filmit, letërsisë dhe publikimeve si dhe në fushën e përkthimit të veprave letrare dhe literaturës profesionale.
- d) në promovimin e bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë në fushën e bibliotekarisë dhe arkivave;
- e) në promovimin e bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë , shkëmbimit të informacioneve në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të muzeve federale austriake me muzetë publike kosovare;

(3) Për të zhvilluar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave, sipas mundësive të tyre, palët kontraktuese do të mbështesin, vizita të shkurtra të artistëve dhe ekspertëve në vendet respektive.

Neni 5

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave në sferën e të rinjve është parimisht i mirëseardhur.. Do të shikohen mundësitë në kuadër të kapitullit: Rinia në Programin e BE-së "Erasmus+" (2014-2020; respektivisht programet vijuese si vazhdimësi e programit "Erasmus+").

Neni 6

(1) Palët kontraktuese mirëpresin bashkëpunimin në fushën e sportit, në veçanti bashkëpunimin mes të rinjve dhe organizatave të tyre, organizatave sportive të shteteve të të dyja palëve kontraktuese, shkëmbimin e informacioneve, publikimeve shkencore dhe materialeve tjera në temën e sportit.

(2) Palët kontraktuese mirëpresin bashkëpunimin në aspektin e programeve kërkimore shkencore dhe projekteve në sport.

Neni 7

(1) Në kuadër të legjislacionit në fuqi në vendet përkatëse, palët kontraktuese do të lehtësojnë themelimin dhe veprimtarinë e institucioneve kulturore të cilat ekzistojnë jashtë përfaqësive diplomatike të shtetit tjetër kontaktues.

(2) Institucionet kulturore në kuptimin e paragrafit 1 do të jenë institucionet e artit, të shkencës dhe organizatat arsimore, bibliotekat, sallat e leximit si dhe institucionet kërkimore publike të cilat financohen tërësisht ose kryesisht prej fondeve publike.

Neni 8

(1) Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të formohet një Komision i Përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e organeve kompetente të shteteve të palëve kontraktuese dhe në mbledhjet e tyre mund të ftohen edhe përfaqësues të autoriteteve rajonale. Një mbledhje e Komisionit të Përbashkët do duhej të mbahej çdo 5 vjet, por sipas nevojës së secilës palë kontraktuese Komisioni mund të mblidhet edhe jashtë intervalit të përcaktuar kohor. Komisioni i Përbashkët do të mblidhet sipas radhës në Republikën e Austrisë dhe në Republikën e Kosovës. Ai kryesohet nga udhëheqësi i delegacionit të shtetit në të cilin mbahet mbledhja.

(2) Komisioni i Përbashkët vlerëson realizimin e shkëmbimeve dhe veprimeve të tjera të përbashkëta të parapara në këtë marrëveshje, dhe paraqet rekomandime e propozime për bashkëpunim në të ardhmen, përfshirë edhe sugjerime për çështje organizative dhe financiare.

(3) Përmes rrugëve diplomatike secila palë kontraktuese njofton për përbërjen e delegacionit të përfaqësuesve në Komisionin e Përbashkët si dhe për ndryshimet e mëvonshme.

(4) Konkluzionet e Komisionit të Përbashkët do të merren në formë të procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të Përbashkët, ndërsa për tekstin përmbajtësor do të dakordohen të dyja delegacionet.

Neni 9

(1) Dispozitat e kësaj marrëveshjeje janë të aplikueshme në bazë të ligjeve të aplikueshme të palëve përkatëse dhe të normave të së drejtës ndërkombëtare.

(2) Kjo marrëveshje nuk ndikon në detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare e që janë obligative për shtetet e palëve kontraktuese.

Neni 10

(1) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason muajin në të cilin palët kontraktuese, përmes rrugës diplomatike kanë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim, se janë përmbushur kërkesat e brendshme shtetërore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

(2) Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohore prej pesë vjetësh. Vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje do të zgjatet edhe për pesë vjet të tjera në rast se njëra palë nuk e njofton palën tjetër me shkrim gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë dhe përmes rrugës diplomatike që nuk e dëshiron vazhdimin e saj. Gjatë periudhës së vlefshmërisë pasuese pesëvjeçare, marrëveshja mund të ndërpritet sipas njoftimit përmes rrugës diplomatike me shkrim gjashtë muaj më herët, në çdo kohë, nga secila palë.

(3) Ndërprerja e marrëveshjes nuk ndërpreu zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të cilat mund të kenë filluar më herët.

(4) Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, në marrëdhëniet midis palëve kontraktuese, shfuqizohet Marrëveshja e arritur mes Republikës së Austrisë dhe Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë mbi bashkëpunimin në fushat e kulturës, shkencës dhe arsimit, e nënshkruar nga palët në Vjenë, më datë 12 prill 1972.

Nënshkruar në Vjenë, më 26 Gusht 2015, në dy kopje origjinale, në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, me ç'rast të dy kopjet janë autentikisht të njëjta.

Për Qeverinë e Republikës së Austrisë:
Sebastian Kurz

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës:
Hashim Thaçi